
	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
		Faqe	Faqe 1 prej 3
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Versioni	1.0

Plani i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve

2024

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
		Faqe	Faqe 2 prej 3
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Versioni	1.0

6. SHTOJCË

6.1. Projektet në tension të ultë

Sipas projekteve PLC të realizuara niveli i humbjeve ka rënë në mënyrë të theksuar. Ne presim zvogëlim të humbjeve duke zhvilluar projektet e parapara në planin investiv një vjeçar.

Për parashikim të humbjeve, llogaritjet janë bazuar në zvogëlimin e humbjeve të 258 TS 10/04 kV të përfunduara, ku për kalkulim është marrë periudha krahasuese 12 mujore, ku përfshihen 27,856 konsumator në projekte të Tension të ultë (TU).

Energjia në hyrje të TS-ave në listën e projekteve për investime gjatë periudhës 12 mujore përgjatë 2021 ka qenë 196,900 MWh.

Për vitin 2023 po të mos kishte investime humbjet në përqindje do të ishin të njëjta 30.62 % , respektivisht humbjet e energjisë elektrike do të ishin 32,069 MWh.

Bazuar në analizat e projekteve të përfunduara siç janë të cekura më lartë, me të dhënat historike të projektit PLC, niveli i humbjeve vjetore është arritur në 8.86 %.

Bazuar ne Planin Investiv 2024 përfitimi i projekteve te TU do te jete **12,204 MWh** ose 0.19 % e vlerës se EED se parashikuar per 2024.


Tabela 7. Parashikimi i zvogëlimit të humbjeve në TU

Përshkrimi	Vlera
EED 2024 (MWh)	6,318,911
Përfitimi i pritur (MWh)	12,204
Zvogëlimi i humbjeve p p	0.19

6.2. Projektet në tension të mesëm

Përzgjedhja e projekteve të TM është bërë sipas kriterëve të paracaktuara nga OSSh dhe si rrjedhojë e këtyre kriterëve është bërë përcaktimi i përfitimit në kuptimin e zvogëlimit të humbjeve.

Kalkulimi i zvogëlimit të humbjeve në tension të mesëm (TM) është bërë duke analizuar gjendjen para dhe pas investimit, ku këto kalkulime merren nga softueri DigSilent. Për gjendjen ekzistuese, daljet e TM veçse

	NJËSIA PËR KONTROLLIMIN E HUMBJEVE NË TEREN	Nr.	KEDS-EL-F-DLS-12
		Faqe	Faqe 3 prej 3
	PLANI I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR MENAXHIMIN DHE REDUKTIMIN E HUMBJEVE	Versioni	1.0

janë të modeluara në softuer, kurse për gjendjen pas investimit, modelohet gjendja e propozuar dhe kalkuloohen humbjet teknike në daljen përkatëse.

Ne tabelën në vazhdim është përmbledhur përfitimi kWh për 2024 dhe ndikimi në zvogëlimin e humbjeve totale. Bazuar ne Planin Ivnestiv 2024 përfitimi i projekteve te TM do te jete 8,128 MWh ose 0.13 % e vlerës se EED se parashikuar per 2024.

Tabela 9. Parashikimi i zvogëlimit të humbjeve në TM

Përshkrimi	Vlera
EED 2024 (MWh)	6,318,911
Përfitimi i pritur (MWh)	8,128
Zvogëlimi i humbjeve p p	0.13

6.3 Përmirësimet Operative

Ekipi i Kontrollit të Humbjes synon të kontrolloj rreth 87,500 konsumatorë gjatë vitit për inspektim në lidhje me sistemin e matjes. Përmes procesit të tillë të kontrollimit, gjatë vitit 2024 synojmë të arrijmë të zbulojmë 13,000 MWh për rikthimin e humbjeve. Njëkohësisht, synojmë të rrisim raportin e leximit dhe faturimit për 5,078 MWh.

Tabela 11. Parashikimi i zvogëlimit me rikthim të humbjeve

Përshkrimi	Vlera
EED 2024 (MWh)	6,318,911
Përfitimi i pritur (MWh)	13,000
Zvogëlimi i humbjeve p p	0.21

Tabela 12. Parashikimi i zvogëlimit me përmirësimet operative

Përshkrimi	Vlera
EED 2024 (MWh)	6,318,911
Përfitimi i pritur (MWh)	5,078
Zvogëlimi i humbjeve p p	0.08

(Fundi i dokumentit)